



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

*Komisioni hetimor i Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve të rënda kushtetuese nga
Presidenti i Republikës së Shqipërisë”*

PROCESVERBAL

Tiranë, më 18.05.2021, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Alket Hyseni – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë dëgjimore me Presidentin e Republikës.
2. Vazhdimi i komunikimit të përgjigjeve të institucioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe i prezantimit me informacionin e ardhur nga Autoriteti i Medieve Audiovizive.
3. Çështje të tjera.

Marrin pjesë:

Alket Hyseni, Klotilda Bushka, Vasilika Hysi, Arlind Çaçani, Elena Xhina, Spartak Braho, Halil Jakimi, Nikolin Staka, Edmond Stojku dhe Eugen Bojaxhiu.

Mungojnë:

Myslim Murrizi

Të ftuar:

HAPET MBLEDHJA

Alket Hyseni – Mirëmëngjesi!

Fillojmë mbledhjen e komisionit hetimor të Kuvendit “Për hetimin e shkeljeve kushtetuese nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë”.

Kuorumi është i mjaftueshëm që mbledhja të konsiderohet e vlefshme. Janë të pranishëm 8 anëtarë të përhershëm të komisionit dhe 1 anëtar zëvendësues.

Pika e parë e rendit të ditës së sotme është dëgjesa me Presidentin e Republikës.

Pika e dytë e rendit të ditës është vazhdimi i komunikimit të përgjigjeve të institucioneve të tjera të Republikës së Shqipërisë dhe i prezantimit me informacionin e ardhur nga Autoriteti i Medieve Audiovizive.

Pika e tretë e rendit të ditës është çështje të tjera.

Ju bëj me dije se me shkresën nr.1081/29 të protokollit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 17.5.2021, Presidenti i Republikës i ka komunikuar Kryetarit të Kuvendit mospraninë e tij në dëgjesën e sotme, ku, pasi ngre disa pretendime për pabazueshmërinë ligjore të këtij komisioni hetimor, konteston legjitimitetin e Kuvendit; vlerëson se ky Kuvend ka njëanshmëri politike apo përkatësi njëpartiake; ngre pretendime procedurale për komunikimin e shkresave, për pabazueshmërinë ligjore të këtyre shkresave të Kuvendit dhe të komisionit hetimor, si dhe ngre pretendim procedural për pamundësinë e paraqitjes, pasi në të dyja rastet kur i është komunikuar thirrja nga Kuvendi, nga Komisioni i Ligjeve dhe komisioni hetimor, e ka pasur të pamundur të marrë pjesë, sepse, sipas zyrës së Presidentit, ky i fundit ka pasur aktivitete të parashikuara, të njoftuara dhe në Zyrën e Protokollit të Shtetit, takime me presidentë të huaj apo samit me aktivitet politik, me homologë, sikurse ishte dhe rasti i fundit.

Secili nga anëtarët e komisionit mund të njihet me tekstin e plotë të shkresës dhe me argumentet e detajuara nga Presidenti i Republikës.

I lutem sekretarisë të bëjë fotokopjimin e shkresës dhe ajo të jetë në çdo dosje të anëtarëve të komisionit!

Pra, duke nisur me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës, në mungesë të Presidentit të Republikës, kjo dëgjese nuk do të bëhet sot.

Për të mundësuar dëgjesën me Presidentin e Republikës, në funksion të objektit të veprimtarisë së këtij komisioni, në funksion të transparencës së opinionit publik, me qëllimin për të dëgjuar edhe palën tjetër, e cila është pala nën “hetim” sipas Kushtetutës, Rregullore së Kuvendit dhe ligjit “Për komisionet hetimore”, por edhe si detyrim e këtij komisioni për ta thirrur dhe për ta dëgjuar Presidentin e Republikës dhe e drejtë dhe detyrim i Presidentit të

Republikës për të shprehur qëndrimin e tij në këtë komision në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, unë do të propozoj që t'i nisim një shkresë Presidentit të Republikës qysh sot, ku t'i komunikohet që ky komision është gati për ta dëgjuar që nga dita e nesërme deri ditën e hënë.

Le të zgjedhë Presidenti i Republikës një nga këto data, edhe orën që dëshiron, pra t'ia japim këtë mundësi, për të mundësuar ato që thashë më parë, por edhe për t'i hequr kujtdo çdo alibi për t'iu shmangur detyrimeve kushtetuese, ligjore, rolit të kontrollit parlamentar në një republikë parlamentare, si Republika e Shqipërisë.

A jeni dakord me këtë propozim? Mund ta hedhim në votë nëse nuk ka një propozim tjetër?

Nuk ka.

Atëherë hedhim në votim propozimin tim për t'i dhënë mundësinë Presidentit për t'u dëgjuar sipas afatit nga dita e nesërme, që është data 19 maj deri ditën e hënë, sa i bie data.

Të bëj edhe një shpjegim: ky afat ka lidhje edhe me afatin e veprimtarisë së Kuvendit. Ne e kemi të pamundur që, përtej ditës së hënë, datë 24 të zhvillojmë veprimtarinë hetimore. Kuvendi na ka mandatuar për një afat 3-javor dhe, duke pasur parasysh që duhet të mbyllim hetimin, por dhe të kemi mundësi të bëjmë një krehje të plotë të provave, fakteve, apo thënieve të dëshmitarëve dhe, më vonë, për të krijuar bindjen e plotë, si dhe për të marrë vendim secili nga anëtarët, për të mundësuar përgatitjen e raportit për seancën plenare të Kuvendit të Shqipërisë, koha do të ishte e pamjaftueshme, për këtë arsye afati maksimal do të jetë dita e hënë.

E hedhim në votim.

Kush është dakord?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mos u shqetësoni për kalendarin, kalendarin e kemi miratuar vetë dhe vetë mund ta ndryshojmë. Kalendari nuk është i pandryshueshëm, nuk përbën pengesë procedurale. Duke bërë këtë automatikisht kalendari s'pостоhet, kështu që nuk ka asnjë ngërç në këtë aspekt. Nuk kishte ndonjë propozim tjetër.

Zoti Braho, urdhëroni!

Spartak Braho – Jam dakord me procedurën që propozoni, por ne nuk kemi materialin e Presidentit përpara.

Alket Hyseni – Do të fotokopjohet tani dhe do të njiheni me të gjatë mbledhjes.

Spartak Braho – Përpara se të vendosim unë dua të di shkakun e vërtetë, të thuhet publikisht për ne këtu dhe për median se pse nuk vjen. Më zuri veshi sikur thatë që nuk njeh

legjitimitetin e Kuvendit. Kështu është?! Ta lexojmë, por, nëse ai nuk njih legjitimitetin e Kuvendit, ky është puc, domethënë që nuk njih më republikën parlamentare. Kështu është.

Na e lexoni edhe një herë shprehimisht çfarë thotë.

Alket Hyseni- Zoti Braho, së pari, nuk kemi ndërmend të lexojmë të gjithë shkresën e Presidentit, sepse është një shkresë voluminoze, por secili nga ju do ta keni në dosje tani. Në cilësinë kryetarit unë ju komunikova disa nga argumentet e Presidenti të Republikës, ndërsa aty i keni të detajuar. Unë perifrazova me fjalët e mia disa nga argumentet dhe ju thashë arsyet bazike që ka menduar, arsyet parimore që ka ngritur Presidenti i Republikës, arsyet politike dhe procedurale.

Thelbi është që Presidenti sot nuk është dhe ne duhet të marrim një vendim lidhur me veprimtarinë. Qëndrimet tona për të analizuar arsyet pse ai nuk ka ardhur dhe qëndrimin e parlamentit e kemi në dorë ne. Gjatë kësaj mbledhjeje dhe në vijim mund të mbajmë qëndrim.

Unë bie dakord me ju, zoti Braho, që mosnjohja e Kuvendit, mosnjohja e Komisionit Hetimor dhe mosnjohja e kësaj procedure, e cila nuk është procedurë as e zotit Braho, as e zotit Stojku, as e zotit Murrizi dhe as e imja, por është procedurë e përcaktuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është e përcaktuar në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, është e përcaktuar në ligjin për komisionet hetimore dhe ne do ta ndjekim strikt atë. Nëse dikush e shkel, e anashkalon, apo nuk e njih, ky është problemi i tjetërkujt, por nuk do të jetë kurrë problem i Komisionit Hetimor dhe i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Në këtë këndvështrim, ai që nuk njih Kushtetutën dhe ligjin do të jetë një arsye më tepër për secilin nga ne për ta vlerësuar në gjykimin tonë përfundimtar në atë raport që do t'i çojmë seancës plenare. Por të mos paragjykojmë, aty ka edhe dy pretendime procedurale, të cilat, vlejné ose jo është tjetër çështje, nga pikëpamja praktike mund t'i kenë pamundësuar Presidentit të Republikës praninë e tij në Kuvend, në Komisionin e Ligjeve apo në komisionin hetimor. Përtej asaj, nëse privatisht apo personalisht, ne mendojmë që nuk ka arsye më të madhe se paraqitja pranë Kuvendit të Shqipërisë kur ai të thërret, aq më tepër në një procedurë *impeachmenty*, ku çdo veprimtari tjetër, logjikshëm, duhet të kufizohet, për të mos thënë që mund të ndalojë fare. Megjithatë, ky nuk është në vlerësimin tonë, por është në vlerësimin e zyrës së Presidentit. Ne, proceduralisht, morëm vendimin për ta njoftuar.

Sekretaria, e hodhëm në votim? Jo, nuk e kemi hedhur.

Spartak Braho- Për procedurë. Kërkoj 5 minuta pushim.

Alket Hyseni- E miratojmë kërkesën e zotit Braho. 5 minuta pushim.

(Rifillon Mbledhja)

Alket Hyseni - Rifillojmë mbledhjen pas pushimit të kërkuar nga zoti Braho.

Shkresa e Presidentit të Republikës është fotokopjuar dhe janë njohur deputetët, pra janë njohur në kuptimin formal, sepse ndoshta për shkak të volumit të shkresës mund të duhet kohë më e gjatë për ta studiuar. Në këtë këndvështrim, unë do të kërkoj mirëkuptimin tuaj që sot nuk ka nevojë ta ezaurojmë debatin për këtë shkresë, ajo do të administrohet në cilësinë e provës, ashtu si çdo komunikim me Presidentin Republikës dhe me çdo institucion tjetër të Republikës së Shqipërisë nga ky komision hetimor. Sipas kalendarit dhe planit të hetimit, në seancën e ardhshme, ne të debatojmë apo të shqyrtojmë këtë provë dhe provat e tjera.

A jemi dakord që ta hedhim në votim propozimin tim për t'i nisur shkresë Presidentit për ta thirrur për ta dëgjuar nga dita e nesërme 19 maj 2021 deri në...

Spartak Braho – Dakord.

Alket Hyseni - Zoti Braho ta hedhim në votim.

Spartak Braho - A mund të bëj një koment?

Alket Hyseni - Sipas rregullit kur jemi në votim...

Spartak Braho - Të bëj një koment

Të lutem, do ta jap fjalën, por pas kësaj bëje komentin!

Dy herë më keni ndërhyrë në votim, në votim nuk ka ndërhyrje as për procedurë dhe për asgjë.

Kush është dakord me propozimin? Kundër? Abstenim?

Miratohet me të gjitha votat.

Urdhëroni, zoti Braho!

Spartak Braho - I nderuar zoti kryetar, ju bëtë shumë mirë që na dhatë kohë, sepse lexuam aq sa patëm mundësi të përqendrohemi në përgjigjen e Presidentit, por, meqenëse është rasti, dua të nënvizoj faktin që në këtë përgjigje Presidenti i Republikës e konsideron komisionin hetimor parlamentar të Kuvendit të Shqipërisë abuziv dhe që vepron jashtë përcaktimeve kushtetuese.

Së dyti, shprehimisht ai thotë: “Kreu i shtetit, si përfaqësues i unitetit të popullit dhe garant i Kushtetutës, ka detyrimin të vazhdojë ushtrimin e qetë të funksionit të tij kushtetues, duke injoruar çdo kërkesë që vjen nga një organ kushtetues dhe i paligjshëm, siç e keni emërtuar komisionin hetimor”. Pra, me këtë perifrazim Presidenti i Republikës në esencë ka shkëputur çdolloj marrëdhënieje institucionale, ligjore bazuar edhe në Kushtetutë me komisionin hetimor.

Megjithatë, unë pajtohem plotësisht që ne të vazhdojmë procedurat, sepse këto procedura kanë vlerë edhe për një të pandehur ordiner, jo më për këtë, që konsiderohet

president dhe që dua të theksoj, fiks para 4 vjetësh ne e kemi zgjedhur President, ky Parlament, kjo legjislaturë e ka zgjedhur President.

Ju faleminderit!

Alket Hyseni – Ju faleminderit, zoti Braho!

Ka dikush tjetër ndonjë koment të përgjithshëm apo të vazhdojmë me pikën e dytë?

Unë përcaktova që do të administrohet si provë sipas kalendarit, proceduralisht do të bëjmë në seancën e ditës së hënë besoj, sipas kalendarit, administrimin procedural të provave, por sekretaria të administrojë në dosje këtë shkresë, për t'u pasur në konsideratë që të na vihet në dispozicion si një provë që do të vlerësohet nëse do të administrohet apo jo në seancën e vlerësimit të administrimit të provave.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës

Kemi përgatitur si kryesi e këtij komisioni disa informacione të ardhura nga Autoriteti i Mediave Audiovizive, në vijim të informacioneve që ne ju bëmë me dije anëtarëve të komisionit, por edhe opinionit publik në mbledhjen e kaluar, dhe po ashtu sot do të vijojmë me disa sekuenca filmike të dërguara nga AMA, si dhe disa deklaramë publike të Presidentit të Republikës të dhëna në media apo në rrjetet sociale personale të Presidentit, apo të zyrës së Presidentit, pjesëtarëve të stafit të tij.

Jemi gati, teknika? Po, mund të fillojmë me transmetimet.

(Shfaqet videoja.)

“Enton Abilekaj - Keni pasur ndonjë përgjigje nga Kontrolli i Lartë i Shtetit?

Ilir Meta – Nuk është se kam pasur...

(Presidenti shikon telefonin dhe fillon të shkruajë.)

Më fal.

Çim Peka - Kryetari i shtetit është në detyrë në çdo sekondë dhe sigurisht që ka edhe gjëra urgjente që nuk mund të presin.

Enton Abilekaj - Duhet të jetë përgjigja që duhet t'i ketë dhënë SPAK-u.

Ilir Meta – Just a moment.

Bledian Koka – A, qenka komunikim ndërkombëtar?

Ilir Meta – No.

Ku e lamë muhabetin?

Enton Abilekaj - Te Kontrolli i Lartë i Shtetit në “Albcontroll”.

Po, Për këtë. Jo, nuk kam pasur ndonjë përgjigje, kam pritur nga Kontrolli i Lartë i Shtetit edhe për çështjen e inceneratorëve qëndrime më të qarta për këtë çështje, megjithatë situatën e kam më të qartë. Ndërkohë, ata kanë procedurat e tyre, domethënë. Po vazhdojmë.

Çim Peka - Zoti President, duke qenë live, çfarë ju bëri me kaq rëndësi t'i kushtoni vëmendje celularit? S'besoj se ju shkruan Juri Kim?

Ilir Meta – Ajo shkruajti dhe i dhashë një përgjigje.

Çim Peka - Dakord.

Ilir Meta – Se më tha duhet të ndaloni për këto çështjet e sfurqeve dhe unë i thashë, duhet të ndalosh duke mbështetur Ramën për të dhunuar zgjedhjet.

Çim Peka - Po i shkruani live?

Ilir Meta – Po, ia thashë këtë gjë dhe do i them edhe gjëra të tjera.

Bledian Koka – Ishte reagimi tani?

Ilir Meta – Po, po, tani. Dhe duhet të kërkojë zbardhjen e çështjes së Elbasanit, urgjentisht ajo. Kaq. Dhe ka bërë shumë gabim që ka mbështetur Edi Ramën për të shkelur marrëveshjen e 5 qershorit, që e mbështetën Shtetet e Bashkuara dhe që u nënshkrua në tokë amerikane. Unë jam transparent, nuk kam asnjë shqetësim.

Çim Peka – Që ta kuptojë publiku...

Ilir Meta – Kaq, u kam thënë ndërkombëtarëve: “Reagoni sot, mos prisni ditën e hënë ju, mos prisni ditën e hënë”, në qoftë se krijon probleme për zgjedhjet për të na thënë: “Epo tani u prishën zgjedhjet dhe ju tani gjeni gjuhën”. Jo, sepse zgjedhjet nuk po i prish opozita, nuk po i prish Presidenti, por po i prish një person, që është Edi Rama. Kaq. Unë jam transparent, nuk kam asgjë për të fshehur.

Juve nuk ju ngelet hatri që i ktheva përgjigje ambasadores E përshëndes ambasadoren dhe i them që Shtetet e Bashkuara duan zgjedhje të lira dhe demokratike, nuk duan një gangster në Shqipëri, as një milion shqiptarë amerikanë atje. Po i them ambasadores atë që i kam thënë ditën e parë që më ka ardhur në zyrë, që ajo është përgjegjëse për marrëdhëniet midis Shqipërisë dhe Amerikës, nuk është për marrëdhëniet midis Serbisë dhe Amerikës. Për marrëdhëniet midis Serbisë dhe Amerikës është ambasadorja apo ambasadori amerikan në Serbi Kaq. Mbaroi historia.

Çim Peka – Pra, një kërkesë që jua ka bërë ambasadorja Yuri Kim me SMS i kthyet përgjigje tani.

Ilir Meta – Doni të jem transparent? Unë jam. Po të dojë, të vijë këtu edhe me Edi Ramën dhe kë të dojë. Unë jam këtu që populli shqiptar të marrë sovranitetin e tij në dorë. Ambasadorja e Amerikës nuk më tregon dot mua se çfarë duhet të bëj unë për llogari të Edi Ramës. Ambasadorja e Amerikës nuk më merr dot mua në telefon (po ja them këtu asaj, meqë ja thashë edhe dje) për llogari të Edi Ramës dhe të më thotë një ditë para mbledhjes të

një institucioni shumë të rëndësishëm si KED-ja, që të pranoj unë të kthehet përsëri Dvorani në KED pasi Venecia e tregoi shumë qartë se çfarë është Dvorani.

Bledjan Koka – Pse, jua ka kërkuar këtë?

Illir Meta – Po, ma ka kërkuar këtë gjë dhe po e them sot këtu. Ka bërë shumë gabim, se e ka bërë për llogari të Edi Ramës, jo të Amerikës. Amerika kërkoi Venecian dhe Venecia e tregoi qartë që Dvorani e dhunoi Gjykatën Kushtetuese. Vazhdojmë përpara. Ecim. Nuk kam asnjë merak unë. Unë e dua shumë ambasadorin dhe të gjithë. Transparenca kjo është.

Më tha që kam bërë një deklaratë për këtë punën e sforcëve, kurse unë i thashë ndalo së mbështeturi Edi Ramën. I thashë që nëse ti dhe të tjerët do të kishit reaguuar në kohë për çështjen e Kavajës, nuk do të kishte ndodhur vrasja në Elbasan. I thashë që ke bërë shumë gabim që ke mbështetur Edi Ramën për të prishur marrëveshjen e 5 qershorit. U bë marrëveshja e 5 qershorit, por si i jep ti këtij parlamenti, me njëqind e njëzetë e ca deputete kukulla, që të bëjnë këtë gjë?

E duan Amerikanët Edi Ramën, ta marrin në Amerikë, ta bëjnë çfarë të duan, ama këtu në Shqipëri do të vendosë populli i Shqipërisë. Mbaroi historia. Ne për këtë e duam Amerikën, për zgjedhjet e lira dhe të ndershme, për asgjë tjetër nuk e duam. Po të jetë se kemi frikë nga Amerika se ka aeroplanmbajtëse dhe raketa, duhet të kemi frikë edhe nga Rusia se ka edhe Rusia, ka edhe ai koreanoveriori raketa. Ne e duam për demokracinë, për zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Në Shqipëri është vetëm një kërcënim për zgjedhjet e lira dhe të ndershme, është Edi Rama, askush tjetër, nuk është as Lulzim Basha. Mbaroi historia.

Enton Ablemekaj – Zoti Meta, ju vërtet mendoni që e duan amerikanët Edi Ramën?

Illir Meta – Jo, nuk e duan amerikanët Edi Ramën. Edi Rama është një korrupsion ndërkombëtar, një lobim ndërkombëtar, siç mori fotografinë me Presidentit Obama si gruaja e Bilalit. Bën këto lojërat dhe filmat. Kaq. Nuk do Amerika gangsterë. Thonë që Amerika donte Markosin. Punonte me Markosin për sa kohë e pranonte populli. Kur populli doli në rrugë, i tha Markosit ik, ne jemi me popullin. Amerika është me popullin, me demokracinë. Kaq

Enton Ablemekaj – Ambasadorja Amerikane ka bërë një deklaratë ku ka kërkuar të zbardhet sa më shpejt çështja e Elbasanit.

Illir Meta – Shumë mirë ka bërë. Unë e kam përforcuar me disa pyetje më konkrete. Kaq. Mbaroi filmi.

Çim Peka – Megjithatë, zoti President, duke qenë se ambasadorja e di që jeni live dhe ju shkruan në këtë moment ...

Ilir Meta – Unë ambasadoren e kam shpirt, e përqafoj nga larg.

Çim Peka – A mos është ky një provokim ndaj jush?

Ilir Meta – Nuk ka provokim ndaj meje fare, fare!

Unë me Amerikën jam i qartë, jam i pastër. Unë ia them Amerikës në sy: “Të dua shumë, por pas Shqipërisë”. Kështu i kam thënë edhe para dy ditësh. Ia kam thënë më parë. “Kam Shqipërinë të parën, kam ca vende bosh, pastaj kam Amerikën. Dhe Amerikën e dua për aq kohë sa nuk dëmton Shqipërinë”, pikë!

Tjetër, i kam thënë Amerikës: “Unë te Gjykata Kushtetuese e kam vijë të kuqe, flakë të kuqe”, i kam thënë, sepse ne Kushtetutën e kemi bërë bashkë me Amerikën. Dakord? Për qejfin e Edi Ramës, unë nuk bëj gallatë me Shqipërinë! Kjo është.

Bledian Koka – Zoti Meta, nga buron fuqia e zotit Rama te zonja Kim, meqë thoni që më shumë sesa një herë ajo e ka mbështetur atë?

Ilir Meta – Nuk ka asnjë problem për këtë çështje. Nuk po flas për këtë punë. Ajo ka punën e vet. Ashtu e informojnë, ashtu ia përkthejnë. Ju e dini që 600 punonjës ambasadash kanë patronazhistë, apo jo? Varet se si ia përkthejnë, si e informojnë, si ia bëjnë; punë e saj. Nuk më intereson fare.

Enton Abilekaj – Ja ky është *Twitter*-i i ambasadores. Ta lexoj unë *Twitter*-in e ambasadores?

Ilir Meta – Nuk më intereson fare *Twitter*-i. E mori përgjigjen. Do përgjigjen që i dhashë?

Gazetar – Meqenëse duam përgjigjen...

Ilir Meta – Nuk kam asnjë shqetësim për *Twitter*-in e ambasadës. Nuk më intereson fare *Twitter*-i i ambasadës. Në Republikën e Shqipërisë jam unë President, jam unë Kryetar i Shtetit!

Ambasada të reagojë sot ndaj shkeljeve që bën Edi Rama! Ambasada nuk duhet të kishte përkrahur kurrë...

Më fal, më fal, zotëri, e lëmë atë!

Nuk duhet të kishte përkrahur shkeljen që i bëri Edi Rama marrëveshjes së 5 qershorit; e përkrahu! Ia kam thënë në sy.

Kaq. Mbaroi filmi!

Çim Peka – Megjithatë, që të mos bëhemi si tek Top-Channel.

Ilir Meta – Nuk ka rëndësi fare reagimi.

O zotëri...

Më fal, më fal!

Ambasada Amerikane të shikojë punën e saj!

Unë jam Presidenti i Republikës, jam Kryetari i Shtetit, jam këtu për zgjedhje të lira e të ndershme, pikë!

Çim Peka – Por që...

Ilir Meta – Të dënojë dhunën në kohë dhe SPAK-u i saj, ia kam çuar, të veprojë në kohë. Kaq. Mbaroi historia!

Enton Abilekaj – Ta lexojmë për publikun?

Ilir Meta – Lexoje, lexoje.

Çim Peka – Jo, për të qenë transparentë edhe për publikun, se çfarë ka thënë ambasadorja.

Enton Abilekaj – “Është e papranueshme për çdo njeri”, - thotë “që kërcënon qytetarët të marrin sfurqet më 25 prill nëse ata nuk e pëlqejnë rezultatin e zgjedhjeve”.

Ilir Meta – E para, ambasadorja ia fut kot, se unë nuk kam thënë: “në qoftë se nuk u pëlqen rezultati i zgjedhjeve”, sepse rezultati mund të mos më pëlqejë mua kur unë humbas. Ia ka përkthyer Guri kot, se Guri dihet se ç’është, patronazhist është edhe Guri.

Meqë erdhi situata, ia kam thënë edhe Lu-së, edhe atyre që kanë qenë më përpara. Por kështu është e vërteta.

Më falni! Nuk më intereson fare. Unë nuk kam thënë këtë gjë. Kam thënë: në qoftë se preket vota dhe në qoftë se preket vota, Ambasada të mos presë asnjë qëndrim tjetër. Kaq.

Bledian Koka – Zoti President...

Ilir Meta – Ambasada duhet të bëjë çdo gjë që të mos preket vota!

Bledian Koka – Vazhdon...

Ilir Meta – Më fal, më fal!

Ambasada dhe të gjithë të tjerët. Kaq. Mbaroi historia.

Më 25 prill do të flasë populli i Shqipërisë!

Bledian Koka – Vazhdon paralajmërimi...

Ilir Meta – Më fal!

Këtë të çmendur le ta marrin në Amerikë po të duan ata, në qoftë se duan!

Kaq!

Bledian Koka – Zoti President, vazhdon paralajmërimi, sepse...

Enton Abilekaj – “Këto kërcënime”, thotë...

Bledian Koka – “Ata që nxisin...

Enton Abilekaj – ...meritojnë ndëshkim”.

Ilir Meta – Harroji ato! O zotëri! Kur ta kuptojë ambasada se çfarë ka thënë...”

Enton Abilekaj – ...Do të jenë përgjegjës për rezultatet, për fjalët e tyre dhe zërin e tyre.

Bledian Koka – “Stop!”, thotë ambasada.

Ilir Meta – Ore, harroji këto! Ambasada, stop se ndërhyri kot më kot në punët e Shqipërisë për llogari të Edi Ramës dhe të personave të tjerë! Kaq. Ta mbyllim këtë histori!

Bledian Koka – Dakord.

Ilir Meta – Ambasada të merret tani me ato çështje që ia kam thënë unë në takim ambasadores. Dakord? Kjo është historia. Mbaroi historia e kësaj pune.

Çim Peka – Fakti që zonja Kim reagoi në këtë moment, është duke ju ndjekur *live*.

Ilir Meta – Po të më ndjekë *live*. Unë e përqafoj shumë dhe nuk kam asnjë shqetësim për këtë punë.

Çim Peka – Përqaqim i pritshëm është ky në këtë moment.

Ilir Meta – Po, patjetër, more. Unë jam i hapur. Unë jam transparent.

Çim Peka – Pak më parë, zoti Koka ju pyeti: “Ku e gjen këtë fuqi Edi Rama?”, ndërsa unë po ju pyes: “ku e gjen këtë fuqi Ilir Meta të jetë kaq i prerë me ambasadorin e Shteteve të Bashkuara të Amerikës?”

Ilir Meta – Ilir Meta e gjen këtë fuqi te raporti i tij i ndershëm me popullin e Shqipërisë, një, me Kushtetutën e Shqipërisë, dy, me Shtetet e Bashkuara, tre. Ilir Meta nuk ka pasur marrëdhënie perfekte me disa ambasadorë amerikanë; kjo është një gjë e ditur, por jo për faj të Ilir Metës, por për punët e tyre. Ata duan të jenë të njëanshëm. Le të jenë.

Ilir Meta ishte i vetmi, që ndikoi të bëhej reforma në drejtësi me 140 vota. Nuk e bëri as ambasadori amerikan, as ajo europiane, as Edi Rama, asnjë tjetër, por e bëri Ilir Meta, që i mblodhi të gjithë bashkë dhe aty i imponoi. I vetmi, që nuk erdhi, ishte Edi Rama, dhe u detyrua të jepte votat, 140 vota. Ilir Meta nuk i ka asnjë faj Donald Lu-së dhe Romana Vlahutin, që më pas ia dhanë Edi Ramës Prokurorinë e Përgjithshme me 69 vota, kundër Kushtetutës. E kanë thënë më parë: “duhet të bëjmë dialog, që të zgjedhim prokurorin me 84 vota, me standarde”. Punë e tyre, nuk ka asnjë gjë.

Ilir Meta nuk ka asnjë detyrim ndaj Shteteve të Bashkuara, sepse ka qenë shumë i ndershëm dhe shumë i pastër me ta gjithmonë.

Kjo më ka thënë mua, zonja e nderuar, që ta dini ju dhe të gjithë shqiptarët, meqë hyri kjo në këtë lojë. Donte të hynte në këtë lojë? Ta bëjmë lojë tamam. Më ka marr në telefon. Unë kisha bërë një letër, sepse këta donin ta fusnin përsëri në KED Dvoranin, dhe i them: “Thirrini mendjes, sepse ky nuk është as KLGJ; ky është me Venecien...”, e të tjera. Unë e kisha bërë letrën. Nuk do ta botoja letrën në orën 11:00, që ishte mbledhja, sepse nuk doja të ndërhyja, si

të thuash, në një vendim të organeve të drejtësisë, dhe kjo më mori mua në telefon dhe më tha: “Ti ke bërë një letër kështu, ndaj, ti”, - më thotë mua, “zotëri, nesër mos bëj zhurmë nëse këta bëjnë kështu, sepse ...”. “Moj, zonjë”, - i them unë, “po ne kemi bërë një marrëveshje, që do të respektojmë Venecien. Ky nuk është as anëtar; nuk është më anëtar i Gjykatës së Lartë, nuk i takon dhe nuk ka se si të jetë këtu”. Jo andej po këtej, më thotë mua: “Ne dimë disa gjëra për ty”. Ambasadorja i thotë Presidentit të Republikës: “Ne dimë disa gjëra për ty”.

“Çfarë dini ju për mua”, - i thashë?

“Nxirrini”, - i thashë, “thojani popullit shqiptar. Unë nuk e shkel Kushtetutën. Unë nuk e shkel marrëveshjen që kemi bërë bashkë për të respektuar Venecien”. “Unë”, - i kam thënë kësaj zonjës, dhe ta dëgjojë ajo tani, meqenëse e porosit Edi Rama të provokojë Presidentin e Shqipërisë dhe të provokojë popullin e Shqipërisë, që e do aq shumë Amerikën, për demokraci dhe për liri, jo se ka frikë nga kjo dhe nga ndonjë njeri tjetër, “e kisha vendosur që këtë letër mund ta publikoja pas vendimit, nëse ata merrnin vendim të gabuar, që të mos ndërhyja”. “Unë tani” - i them, “Në orën 11:00 është mbledhja, në orën 10:00 do ta publikoj letrën, dhe ti, dhe Amerika, çfarë keni për mua, publikojeni. Unë nuk e tradhtoj Kushtetutën e Republikës, dhe unë tani, këtë vagabond, këtë horr, që ti më thua “Pranoje tani”, që ka shkelur, dhe e la Shqipërinë pa Gjykatë Kushtetuese”, nuk pranoj kurrë që ky të vijë atje. Kaq”. Kjo zshhtë historia.

Unë kam respekt për të. Këto gjëra ia kam thënë edhe dje në takim. Erdhi situata këtu, ta dijë ajo. Unë nuk kam thënë: “Njerëzit të marrin sfurqe dhe të mos njohin rezultatin”, por nëse preket vota e popullit, siç është kjo tendencë, pa dyshim që populli shqiptar nuk mund ta njohë këtë rezultat, sepse edhe kolegu i saj, Donald Lu, tha: “Zgjedhjet ishin shumë të mira në Kirgiztan...”

Gazetar – Kush e gjykon?

Ilir Meta - E mbani mend, apo jo?

Gazetar – Ky nuk është modeli i Kirgiztanit.

Ilir Meta – Më falni!

Doli populli Kirgistan dhe tha ai: na falni, por zgjedhjet nuk ishin të mira.

Ndaj, e dashur ambasadore, që të mos kemi rastin e Kirgiztanit: ndiko tek ai i sëmurit psikik, që të mos e provokojë më as Presedentin, as popullin...

Gazetar – Kush e gjykon?

Ilir Meta – Të lutem!

Pra, ta shpëtojmë këtë proces zgjedhor, që është vendimtar për Shqipërinë, jo për 4 vjet, por për 100 vjetët e ardhshëm. Ne e duam Amerikën vetëm për një arsye ose për dy arsye: e para, Amerika është një vend i lirisë, i demokracisë dhe i zgjedhjeve të lira dhe të ndershme.

Së dyti, sepse Amerika na ka përkrahur për çështjen e Kosovës. Këto të dyja janë ato që na lidhin me Amerikën në mënyrë të veçantë dhe në mënyrë të jashtëzakonshme.

Mos u bëj palë në këtë proces, të lutem! Kërko zbardhjen urgjente të çështjes së Elbasanit, kërko nga SPAK-u zbardhjen urgjente të të gjitha krimeve zgjedhore, në mënyrë që të mos kemi krime të tjera zgjedhore dhe populli shqiptar të votojë i lirë dhe në mënyrën më të drejtë, ashtu sikurse presin të gjithë partnerët tanë ndërkombëtarë, se jemi një vend anëtar i NATO-s! Kaq.

Bledian Koka – Po nëse zonja Kim mendon në këto momente: *“Ilir you are doing big mistake talking like this.”*

Ilir Meta – As nuk kam asnjë shqetësim se çfarë mendon ajo. Unë them atë që kam. Unë kam një problem në qoftë se them një gjë ndryshe nga ajo që kam thënë më përpara. Kaq! Pikë! Mbaroi historia!

Enton Abilekaj - Zoti President, kush e gjykon nëse zgjedhjet ishin të lira apo nuk ishin?

Ilir Meta – Populli i Shqipërisë e gjykon.

Enton Abilekaj – Ka OSBE-ODIHR, ka një mision ndërkombëtar...

Ilir Meta – O zotëri unë i nënshtrohem popullit të Shqipërisë. E pranon populli i Shqipërisë, e pranon edhe Presidenti. Mbaroi historia! A keni pyetje tjetër?

Bledian Koka – Ky si nocion “populli i Shqipërisë” i tejkalon institucionet e Shqipërisë.

Ilir Meta – Vazhdojmë, a keni gjë tjetër? Le t’i lemë këto përrallat, se këto funksionojnë me njerëz të dobët dhe me njerëz që kanë për të fshehur. Unë nuk kam asnjë problem për të fshehur as me Amerikën, as me Shqipërinë as me shqiptarët. Pikë!

(Debate në studio)

Enton Abilekaj – Kjo është një çështje shumë e rëndësishme se janë zgjedhjet.

Çim Peka – Po flasim për qytetarët, për vendin tonë tani, përtej Amerikës.

Ilir Meta – Populli i Shqipërisë tani të tregojë se jemi një popull shqiptonjash dhe jo një popull sorrash, që mund ta marrë nëpër këmbë dikush, as Edi Rama dhe askush tjetër. Të gjithë të shkojnë në kutitë e votimit. Kaq. Kjo është detyra jonë sot.

Enton Abilekaj – A do të kemi zgjedhje në paqe dhe sociale në vend, sepse sipas kësaj që thoni ju i bie që zgjedhjet...

Ilir Meta – Paqen sociale e rrezikon vetëm Edi Rama, askush tjetër! Kush e shkeli marrëveshjen e 5 qershorit? Kush e shkeli? Unë e shkela?! Unë insistova që ta firmoste opozita. Insistova, nuk e shkela, e shkeli Edi Rama. Edhe zonja bëri gabim të madh që bëri një deklaratë, ku i jepte dritë jeshile veprimeve të njëanshme të parlamentit njëpartiak, apo jo, se u bë marrëveshja në tokën e saj dhe pastaj ajo... Nuk shkonte kjo gjë!

Bledian Koka – Zoti President, ju folët dhe i thatë të gjitha çfarë kishit për Ambasadën Amerikane, por...

Ilir Meta – Unë nuk kam gjë me ambasadën unë, e kam me deklaratën zonjës, ambasadën e dua shumë.

Bledian Koka – Atëherë, pyetja është: kur thoni “popullsore” duket se artikulimi ose kritika shkon për Xhorxh Sorosin...

Ilir Meta – Më fal, në Shqipëri, zotëri, sot ka një kryetar shteti, që quhet Ilir Meta, President i Republikës së Shqipërisë. Pikë! Janë 100 ambasada, të mbajnë vendin e tyre, kaq.

Bledian Koka – E anuluan.

Ilir Meta – Të mbajnë vendin e tyre ambasadat. Janë 100 ambasada. Pikë! Në qoftë se Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë një problem me Ilir Metën, siç thotë ky qen bir qeni, çuni i Krita Ramës, që vajti dhe u vesh si grua për të bërë një foto të paligjshme, që turpëron çdo njeri normal, jo çdo politikan serioz në Amerikë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës në qoftë se kanë ndonjë gjë me Ilir Metën, meqë thotë ky, nxjerr këta spiunët e UDB-së, Frrok Çupi me shokë...

Çim Peka – Kthehemi te debati.

Ilir Meta – Më fal, më fal! Në qoftë se kanë ndonjë gjë, po u them Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që jua kam thënë: Ilir Meta nuk mendon që është një njeri i pavdekshëm. S’ e ka këtë mendim absolutisht, do të vdesë një ditë si gjithë të tjerët, se ka vdekur Skënderbeu, jo më Ilir Meta. U kam thënë: Në qoftë se keni ndonjë gjë me mua ju më lajmëroni kur e keni, se unë e di që ju më vrisni, i kam thënë. Po të vete te Mali me Gropa dhe më çoni ndonjë raketë që të paktën të mos dëmtoj njerëz të tjerë, se nuk e kam problem, por Shtetet e Bashkuara të Amerikës nuk kanë asgjë me Ilir Metën, se Ilir Meta është politikani më luajal ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës në 30 vjet. Janë qarqe të korruptuara, janë lobingje që i paguan Serbia edhe atje, edhe në vende të tjera, të cilët përdorin përfaqësuesit e Amerikës kundër Ilir Metës.

Në takimin e parë i kam thënë zonjës: “Zonjë je këtu për marrëdhënie mes Shqipërisë dhe Amerikës, jo mes Serbisë dhe Amerikës”. Ajo nuk do të jetë përgjegjëse për këto marrëdhënie, le të vazhdojë me Edi Ramën dhe me të tjerët, që fusin hundët në punët e

Shqipërisë. Kjo është punë e saj, unë nuk e pengoj. Por asgjë nuk e ndryshon qëndrimin e Ilir Metës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pikë, mbaroi historia”.

Çim Peka – Zoti President, a do të jeni kaq i prerë edhe me Kryeministrin në ardhje, nëse vazhdon të njëjtën linjë si Edi Rama?

Ilir Meta – Ore me çdo njeri do të jem njësoj. Çlidhje kam unë? Për sa kohë jam President, jam me Shqipërinë, jam me interesin kombëtar, jam me interesin publik. Mbaroi historia. Çfarë problemi kam unë? Përse do të mbaj hatrin e zotit Basha, apo të Monikës, apo tëndin? Çfarë lidhje ka kjo? Unë kam një raport... Unë kam vënë dorën dhe zërin mbi Kushtetutë. Mbaroi Historia. Sa të jem në këtë detyrë, kur të mos jem pastaj, puna ime”.

Çim Peka – A keni ndonjë prognozë, një parashikim se si do të jetë Shqipëria më 26 prill?

Ilir Meta – Shqipëria do të shkëlqejë më 25 prill. Edhe dëshmorët do të shkojnë të votojnë. Këtu bëhet fjalë për 100 vjet, mor vëlla, me gjithë këto siklete, me gjithë këto reagime. Këto janë reagimet e armiqve të Shqipërisë, që manipulojnë edhe miqtë tanë, sepse është një sekret i madh. Është një projekt 20-vjeçar për shpopullimin e Shqipërisë, për degradimin e rolit të shqiptarëve në rajon. Që kur është çliruar Kosova u punua për këtë gjë dhe tani jemi në një siklet të madh. Çfarë të bëj unë? Çfarë faji kam unë? Unë punoj për Shqipërinë, nuk punoj për asnjë tjetër, dhe për një Shqipëri europiane, për një Shqipëri në NATO, për një Shqipëri demokratike. Për këtë punoj unë. Nuk punoj për Shqipërinë që të ikin shqiptarët dhe të vijnë këta të Bangladeshit dhe të Indisë dhe të na çojnë ata në Europë, se nuk kanë se si të na çojnë ata.

Çim Peka – Mesazh garantues që nuk ktheheni nga rruga juaj nëse preket vota e dhatë, po mesazh paqtues, a keni zoti President?

Ilir Meta – Po, kam. Të gjithë të reflektojnë, të gjithë të respektojnë Kodin, të gjithë të respektojnë Kushtetutën, të gjithë të respektojnë njëri – tjetrin, të evitojnë çdo lloj incidenti, të ecin përpara drejt kutive të votimit, sepse duhet të jetë një ditë bashkimi. Fiton Edi Rama....

(Transmetohet një video tjetër e Presidentit në një emisioni tjetër)

Ilir Meta - “Unë jam i sigurt që 25 prilli është dita e rizgjimit të demokracisë dhe do të jetë një festë e madhe e demokracisë. Shpresoj që të gjithë shqiptarët të bashkohen në këtë festë. Por kush kërkon të prishi festën, duhet të ketë parasysh që nuk do të ketë askush keqardhje që do të bëhet kurban i kësaj feste”.

(Transmetohet një video tjetër e Presidentit)

Ilir Meta - “Janë shqetësuar nga mesazhet e Presidentit? Le të shqetësohen dhe le të tmerrohen të gjithë ata që mendojnë që do të bëjnë tërmet si në Dibër apo si në Shijak, qofshin qeveritarë, qofshin punonjës policie, qofshin banditë, gjithçka qofshin”.

(Transmetohet një video tjetër e Presidentit)

Ilir Meta - Fillojmë atëherë. Gjashtë. Tani SPAK-ut iu deshën 8 ditë që vetëm ta përcillte për hetime në Elbasan, sepse është shumë larg Tiranë- Elbasan. Ndërkohë, që referuar kallëzimit dhe faktit se për kë po punonin çunat problematikë, ishte e qartë se ky material kallëzues duhej të hetohej nga SPAK-u dhe jo nga prokuroria e Elbasanit. Ajo që është edhe më e turpshme është fakti që kjo shkresë e SPAK-ut, që mban datën 15 prill, është rikthyer në prokurorinë e Elbasanit më 19 prill. Kështu thotë shkresa e vetë prokurorisë së Elbasanit e datës 20 prill. Pra, kësaj të fundit ose SPAK-ut bashkë, u janë dashur edhe 4 ditë të tjera vetëm për ta protokolluar këtë shkresë.

Tani vazhdojmë, edhe më keq ende, prokuroria e Elbasanit, që është në konflikt të thellë interesi për zgjedhjet, përmes shkrësës nr. 3640, datë 20 prill, pra një ditë para se të ndodhte hataja e 21 prillit, ka njoftuar zotin Gazmend Bardhi, si përfaqësues të kallëzuesit, për të dhënë shpjegime lidhur me kallëzimin që kishte bërë ai para dy javësh, duke i caktuar atij që të paraqitet në datën 30 prill në orën 10:00, pra 4 ditë pasi ishin të vjedhur zgjedhjet në atë mënyrë dhe të ishin blerë votat. Pra, pas 10 ditësh. Duket qartë nga të gjitha këto, sepse janë të dokumentuara se prokuroria e SPAK-ut, prokuroria e Elbasanit kanë bërë çmos që personat e kallëzuar nga Partia Demokratike për krime zgjedhore të mos hetohen para fushatës, përpara zgjedhjeve, duke u krijuar atyre me qëllim terrenin për të zhvilluar aktivitetin e tyre kriminal zgjedhor në favor të partisë në pushtet. Për shkak të këtyre vonesave të qëllimshme, të pajustificueshme, të papërgjegjshme, kriminale dhe të mos kryerjes së hetimeve në kohë, një ditë më pas, në datën 21 prill ndodhi edhe konflikti i armatosur, i nxitur nga po të njëjtët njerëz që ishin kallëzuar nga Partia Demokratike para dy javësh.

Çfarë provojnë këto fakte? Provojnë se, nëse prokuroria e SPAK-ut do të kishte vepruar në kohë dhe pa asnjë vonesë dhe të kishte thirru kallëzuesin, zotin Bardhi, dhe të gjithë të tjerët në kohë, këta 40 persona, që PD-ja kishte kallëzuar, do të ishin në burg, por ama nuk do të kishim asnjë viktimë, asnjë të plagosur dhe do të ishte shumë i qetë edhe Elbasani, edhe e gjithë Shqipëria. Nëse prokuroria e SPAK-ut, prokuroria...”.

Edlira Rama - Statuse të Presidentit në *Facebook* në faqen e tij zyrtare, datë 2.11.2020. “

25 prilli tashmë është një referendum me dy alternativa: Shqipëria në Europë ose në gropë. Përgjigjja dihet që nga koha e Skënderbeut.

Po vazhdoj me një status tjetër 28 janar 2021.

“Shqipëria nuk futet dot në thes nga një çetë me banditë, oligarkë dhe arrogantë, harrojeni! Më 25 prill 2021 Shqipëria në dorë të shqiptarëve”.

Status në datën 3 mars 2021.

“Shqipëria një hap më pranë autoritarizmit. *Freedom House* e zbret Shqipërinë edhe më poshtë për vitin 2020 mes regjimeve hibride, shembjen e Teatrit Kombëtar për interesa klienteliste, dhunimin e protestuesve dhe vrasjen kriminale të Klodian Rashës. Gjatë kohës së pandemisë nuk mundi të mbulojë asnjë propagandë. Këto dhe të tjera ngjarje të rënda kurrë nuk do të amnistohen dhe për to drejtësia do të vendoset në vend. Përkeqësimi i të gjithë treguesve, veçanërisht shkelja mizore e të drejtave të njeriut, është një kampanë e fortë alarmi për instalimin e shtetit policor që e kam denoncuar prej kohësh. Referendumi i 25 prillit 2021 është momenti historik për t’i dhënë një trajktore të re demokracisë, shtetit ligjor dhe respektimit të të drejtave të njeriut, me qëllim përmbushjen sa më parë të kushteve të vendosura nga Bashkimi Europian”.

Status në datën 11 mars 2021. “As pandemia nuk e ndali shpopullimin e Shqipërisë. Ndonëse në masa kufizuese dhe me kufij pothuajse të mbyllur, shqiptarët, me të gjitha mënyrat, janë përpjekur të largohen jashtë vendit, duke zënë edhe për vitin 2020 vendin e parë në Europë për numrin e aplikimeve për azil nga Ballkani dhe vendin e dytë në botë, pas Sirisë, në raport me popullsinë. Të dhënat e fundit të Zyrës Europiane për Azilin bëjnë të ditur se vitin e kaluar nga Shqipëria ka pasur 6558 aplikime, nga Serbia 2605, nga Kosova 2114, nga Bosnjë-Hercegovina 1329, nga Maqedonia e Veriut 1230 dhe nga Mali i Zi 207. Në këtë përvjetor të eksodit biblik të shqiptarëve, që 30 vjet më parë u larguan nga vendi për t’i shpëtuar diktaturës, duhet të jemi më shumë se kurrë të brengosur për këtë shpopullim dramatik, që qartazi po ndodh për shkak të keqqeverisjes dhe mungesës së shpresës. Më 25 prill kemi një mundësi historike për t’u dhënë përgjigjen e merituar autorëve të këtij projekti antikombëtar, që duan ta zhvatin Shqipërinë, duke e zhbërë. Me kurajë dhe me besim te vota e lirë, me pjesëmarrje masive në zgjedhje, të çelim një epokë të re të ndërtimit të së ardhmes sonë të sigurt europiane, për të nxjerrë nga intubimi demokracinë, për t’i dhënë frymëmarrje lirive dhe të drejtave të njeriut. Do ta çlirojmë Shqipërinë nga thonjtë e oligarkëve, banditëve dhe arrogantëve, rrugë tjetër nuk kemi. Më 25 prill, o kurrë!”

Status në datën 2 prill 2021. “E kam paralajmëruar prej kohësh qeverinë ende në detyrë të heq dorë nga arroganca dhe të tërhiqet nga çdo vendim abuziv e jashtë procedurave ligjore ndaj investitorëve të huaj në vendin tonë. Vetëm për tekat dhe kapriçot personale të Kryeministrit, i cili e urren edhe lirinë e medias, tashmë Shqipëria është e detyruar të paguajë

110 milionë euro. Skandali merr përmasa më të mëdha për shkak se Avokatura e Shtetit e ka gënjyer Presidentin e Republikës, duke pretenduar se nuk e ka humbur gjyqin me kompaninë në fjalë”.

Dëmtimi i tabelës për ndërprerjen e vlefshmërisë së pasaportave për Kombëtaren tonë të Futbollit është i paprecedentë dhe një hakmarrje primitive për shkak të qëndrimeve kritike të disa futbollistëve. Është absurde të pengohen të mbajnë pasaporta kuq e zinjte, që e futën Shqipërinë në Europë.

Jam i bindur se më 25 prill 2021 do të përfundojë koha e vendimeve arrogante, autoritare dhe përjashtuese”.

(Një status tjetër në datën 7 prill).

“Ftohet edhe “Tërmeti” të marrë pjesë për shkak të përvojës së tij me aeroportet, fluturimet dhe jo vetëm”.

Status në datën 12 prill 2021

“Droga dhe trafiket po ia nxijnë faqen Shqipërisë dhe po e rrënojnë. Këtë e thekson qartë drejtuesja e EUROPOL-it, e cila bën përgjegjëse rilindjen, ndaj 25 prilli është referendum popullor, që droga dhe trafiket t’i përkasin të shkuarës”.

Status në datën 13 prill 2021

“Gropat e zeza të inceneratorëve të mafies i thithën 100% paratë e planifikuara për financim nga taksapaguesit në vitin 2020, ndërkohë që pjesa tjetër e projekteve të menaxhimit të mbetjeve shfaqën realizim të dobët. Ndaj 25 prilli është referendum popullor kundër mafies së inceneratorëve, plehrave dhe kandidatëve të saj”.

Status në datën 16 prill 2021

“Edhe ato pak fonde mjerane të përcaktuara nga buxheti për bujqësinë dhe që janë 10 herë më pak se fatura që do t’i paguhet *Becchettit*, harxhohen në pjesën dërrmuese për spote, konferenca, panaire dhe kotësira korruptive”.

Alket Hyseni – Mjaftueshëm!

Faleminderit!

Do të vijojmë në mbledhjet e tjera.

Së pari, do t’ju kërkoja që të mos bëni përsëritje, sepse ka statuse që i kemi lexuar dje. Duhet të jeni të vëmendshëm!

Së dyti, për shkak edhe të organizimit të mbledhjes së Komisionit të Ligjeve, nuk mund të vazhdojmë pa fund me transmetimet sot. Do të kemi edhe seanca të tjera, ku do t’ju ftoja të jeni më koncizë në transmetim. Ndërkohë, deputetët i kanë të plota edhe kronikat, edhe postimet, i kanë në dosjet e tyre, kështu që mund të njihen.

Nëse ka kërkesa nga publiku apo nga media bazuar në ligjin shqiptar për të drejtën e informimit, duke pasur parasysh që ky parlament bazohet në parimin e transparencës, sekretariati teknik t'ua vë në dispozicion të gjitha materialet e ardhura, përveç atyre që janë sekret, kujtdo që është i interesuar për t'u njohur me detaje, me këto prova.

Vazhdojmë. A ka koment ndokush nga anëtarët e komisionit, në lidhje me çfarë dëgjuam?

Po, zoti Stojku.

Edmond Stojku – Në deklaratimet e Presidentit, përveç të tjerave, gjatë gjithë kësaj kohe më ka shqetësuar dhe më shqetëson reagimi i tij për mosnjohjen e parlamentit, duke e ditur se ne jemi Republikë Parlamentare. Njëkohësisht, shfaq injorim ndaj deputetëve, mosnjohje të Komisionit Hetimor, të cilin nuk e njeh, sikur ai të jetë mbi Kushtetutën.

Kujtoj këtu pjesëmarrjen e Presidentit në Komisionin Hetimor 1, ku ai u paraqit, kështu që nuk arrij ta kuptoj përse nuk paraqitet në Komisionin Hetimor 2. Por besoj se edhe deputetëve të parlamentit, edhe mua personalisht, nuk na bëjnë përshtypje këto deklarata të rënda mediatike nga ana e Presidentit. Njëkohësisht, shpreh keqardhjen time në lidhje me deklaratimet e Presidentit të Republikës ndaj ambasadores Kim, ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kur dihet e ekzistenca dhe performanca jonë në rajon, duke llogaritur edhe çlirimin e Kosovës, kanë ardhur si rezultat i mbështetjes së jashtëzakonshme të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, por njëkohësisht edhe të gjithë formacionit të NATO-s.

Pikërisht për gjë çuditem vërtet. Nuk më duket aspak normal fakti që këto komente drejtohen, adresohen ndaj aleatit tonë të madh, aq të dashur edhe për popullin dhe publikun shqiptar: Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Është thjesht konstatim, një konstatim i cili ka filluar që para pak më shumë se dy vjetësh nga ana e institucionit të Presidentit të Republikës, ndaj unë shpreh vërtetë keqardhje kur shoh se vazhdon me të njëjtin temp, me të njëjtin ritëm, me të njëjtat shprehje jointitucionale, që Presidenti i Republikës dhe institucioni i tij i adreson pikërisht ndaj një parlamenti, duke ditur që vendi ynë është Republikë Parlamentare, e po ashtu dhe ndaj një aleati si Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti Stojku!

Ka gjë për të shtuar ndokush tjetër? Do t'ju ftoja të bënit sa më pak komente. Lidhur me këtë, ne do të kemi një seancë, në të cilën do të shqyrtohen provat, pasi të kemi grumbulluar të gjitha provat, që secili të mund të ketë opinionin e tij, ku do ta ftoja që, me gjakftohtësi,

bazuar në atë çka është parashtruar gjatë hetimit në këtë komision, secili të bëjë deklaratën e tij personale.

Nëse s'ka njeri tjetër, që dëshiron të shtojë diçka... Po, zonja Bushka!

Klotilda Bushka – Faleminderit, kryetar!

Referuar kërkesës së dyzet e nëntë kolegëve deputetë, një nga çështjet që ngrihen është edhe veprimtaria e zyrës së Presidentit në lidhje me kthimin e ligjeve, me dekret.

Duke qenë se është pjesë e kërkesës dhe duke iu përmbajtur planit të hetimit kur ne marrim informacione nga institucionet përkatëse në lidhje me objektin e hetimit, unë do u kërkoja shërbimeve të Kuvendit, me një shkresë-kërkesë nga komisioni hetimor, një raport me lidhje me të gjitha ligjet e kthyera me dekret të Presidentit. Sa nga këto dekrete janë rrëzuar, sa janë pranuar? Do të doja një informacion të detajuar në lidhje me ato ligje të cilat janë kthyer me dekret nga Presidenti. Cilat janë pjesët e planit të integritetit të Shqipërisë në BE? Cilat janë punuar me ekspertë të cilët janë financuar apo mbështetur nga BE-ja në kuadër të bashkëpunimit që ka Shqipëria me BE-në sa i takon procesit të hartimit të legjislacionit dhe përafrimit të tij me Acquis communautaire? Ky informacion të na vihet në dispozicion brenda të premtës dhe nëse është e nevojshme të kuptohet se cila është periudha, unë do të kërkoja për periudhën e vitit 2020-2021.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Dakord. Kërkesa miratohet pa u hedhur në votim, sipas parashikimeve të ligjit “Për komisionet hetimore”. Ju lutem, të përgatitet nga sekretaria një shkresë, drejtuar shërbimeve të Kuvendit për periudhën nga shtatori 2020, kur ka filluar punë ky sesion parlamentar deri ditën e sotme!

Klotilda Bushka – Kam edhe një gjë të fundit, që është kërkesë procedurale. Në kërkesën e kolegëve deputetë është edhe lidhja II dhe III. Njëra ka të bëjë me raportimet e ngjarjeve terrorizuese për publikun gjatë periudhës zgjedhore dhe tjetra ka të bëjë me deklaratat dhe mesazhet përfaqësive të huaja në Shqipëri dhe të organizatave ndërkombëtare sa i takon procesit zgjedhor dhe deklaratave të ndryshme të bëra nga përfaqësues të shtetit shqiptar, përfshi edhe Presidentin.

Të gjitha këto që janë në lidhjen II dhe III do të duhet patjetër, nga sekretaria e komisionit, të merren nga sajtet përkatëse dhe siç janë bërë postet e FB-së apo deklarata të tjera, apo edhe ato që janë nga mediet, siç citohen në kërkesën e kolegëve deputetë, t'u vihen në dispozicion anëtarëve të komisionit.

Faleminderit!

Alket Hyseni – Faleminderit, zonja Bushka!

Kam idenë se jemi shprehur për këtë. Pra, çdo përcaktim, çdo pretendim i ngritur në kërkesën e deputetëve, përveç çfarë kanë paraqitur ata, përveç çka do të administrohet në rrugë institucionale, bazuar në ligjin për komisionet hetimore, ku thuhet që grumbullon informacione zyrtare dhe jozyrtare, pjesa tjetër që ka të bëjë me mediet sociale nuk është detyrë e AMA-s, por është detyrë e sekretariatit për të administruar ato prova që pretendohen nga grupi i deputetëve dhe, nëse në ato faqe konstatohen edhe thënie të tjera, të cilat mund të përbëjnë interes brenda objektit të komisionit hetimor, të na vihen në dispozicion.

Do të doja t'ju bëja me dije që ky komision ditën e djeshme ka nisur një kërkesë për vënien në dispozicion të komunikimit me zyrën e Presidentit të Republikës dhe me Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për periudhën objekt hetimi. Njëkohësisht, i është nisur një shkresë Presidentit të Republikës, zyrës së Presidentit për të na vënë në dispozicion informacionet si më poshtë:

-Dekretet për dhënie shtetësie nga Presidenti i Republikës, pra personave që u është dhënë shtetësia, si dhe procedura e ndjekur për dhënien e tyre për periudhën para, gjatë fushatës zgjedhore, ditën e heshtjes zgjedhore, si dhe në datën 25 prill.

-Korrespondenca e Presidentit të Republikës me institucionet ligjzbatuese lidhur me çështjet dhe problematikat e procesit zgjedhor, si dhe me rendin e sigurinë publike për periudhën para, gjatë fushatës zgjedhore, në ditën e heshtjes zgjedhore, si dhe në datën 25 prill 2021.

Duke marrë shkas nga pretendimi i Presidentit të Republikës se kërkesat e bëra nga komisioni nuk janë të bazuara ligjërisht, do të doja që publikisht, përveçse do të komunikojmë edhe me shkresë, t'ju bëj me dije se çdo shkresë e komisionit hetimor është totalisht e bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, është e bazuar në Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në ligjin "Për komisionet hetimore", si dhe në vendimin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë për ngritjen e këtij komisioni hetimor. Prandaj, përtej çdo pretendimi, do të ftoja jo vetëm Presidentin, por këdo tjetër, të kuptojë rëndësinë e këtij procesi, rëndësinë dhe rolin e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, në një republikë parlamentare, që është maja e piramidës së shtetit, detyrimin e kujtdo për të zbatuar përcaktimet në Kushtetutë dhe në ligj, moszbatimi i të cilave na bën përgjegjës dhe ngarkon me faj këdo që nuk i zbaton ato.

Nga ana tjetër, kush ka arsye për t'u fshehur dhe për të mos qenë transparent, do të thotë që hedh hije mbi veten e vet. Unë do të gjykoja që edhe mosdhënia e informacionit shkon në këtë logjikë dhe jo në favor të pretenduesve. Prandaj, do të ftoja këdo që të përgjigjet

saktë, sipas kërkesave të shkresave, por edhe në afat, duke qenë se e kemi të kufizuar afatin e veprimtarisë së këtij komisioni.

Ezauruam edhe pikën e dytë të rendit të ditës për sot.

Nëse dikush ka ndonjë gjë tjetër? Nuk ka.

Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

I falënderoj të gjithë anëtarët e komisionit për përkushtimin, për vëmendjen, për orët e gjata të punës për hulumtimin e një materiali kaq voluminoz!

Falënderoj këshilltarët e komisionit, sekretariatit, po ashtu edhe teknikën, që na mundëson që këto mbledhje të bëhen publike dhe t'i japim mundësi çdo qytetari të Republikës së Shqipërisë për të ndjekur drejtpërdrejt punimet e këtij komisioni hetimor dhe në përgjithësi të gjitha punimet e Kuvendit të Shqipërisë!

MBYLLET MBLEDHJA

Kryetar
Alket Hyseni

Përgjegjëse e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretare e komisionit
Evi Naku